V E N D I M
Nr.210, datë 28.4.1999

PËR LEJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRIVATIZIMIT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT TË KALIMIT TË PRONËSISË PËR TROJET E OBJEKTEVE TË PRIVATIZUARA NGA SHOQËRITË HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rastet kur shoqëritë huamarrëse, subjekte të kontrollit sipas ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1999 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””, kanë kryer pagesa për trojet e objekteve të privatizuara nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, përpara lëshimit të autorizimit për kalim pronësie të truallit nga kjo agjenci, veprimi financiar i kryer (pagesa) të konsiderohet i mirëqenë.
2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit t’u lëshojë autorizimet përkatëse, për kalim pronësie për trojet e këtyre objekteve, administratorëve të shoqërive huamarrëse, sipas kërkesës së tyre dhe dokumentacionit shoqërues.
3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko